



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 466 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

**VENDIM Nr. 70, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues MA. Adrian Anastasi, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues MA. Adrian Anastasi, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - a) Zgjerimi i sipërfaqes nënujore të kërkimeve arkeologjike në Kepin e Rodonit dhe të Lagjit:
    - Marrja e një informacionit sa më të gjërë për këto dy zona, të cilat përfaqësojnë gjeografikisht ekstremet e Gjirit të Durrëst, i njohur si një nga portet më të rëndësishëm të Mesdheut;
    - Vijimi i punës për zonifikimin mbrojtës në Kepin e Rodonit.
    - Vijimi i punës për të ndërtuar planimetrinë e fortifikimit të Gjergj Kastriotit, i cili ndodhet në pjesën më të madhe nënujore;
    - Vijimi i dokumentimit grafik, fotografik dhe video i siteve prehistorike, në liqenet e Ohrit dhe të Prespës;
    - Zgjerimi i kërkimeve vëzhguese në Prespën e vogël.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

3. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO-FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

